



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 114/3 prot.

Tiranë më 27.02.2019

REKOMANDIM

Nr. 15, datë 27.02.2019

PËR KONTROLLUESIN "AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT "

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.17 datë 23.01.2019, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit", me objekt:

- Zbatimi i nenit 18, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale..

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) është person juridik publik, i pavarur, përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 45/2015 lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka vendosur "Politikat e Privatësisë" në faqen [www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al) të institucionit, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë faqe. Informacioni i publikuar në "Politikat e Privatësisë", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që

vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 18 të ligjit nr. 9887/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...* dhe Vendimit nr. 6/2013 *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”*.

2. Kontrolluesi nuk ka *“Njoftuar”* Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21, të ligjit nr.9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr.9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar: *“...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”*.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi dhe nënshkroi në prani të palëve procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e evidentuara nga hetimi administrativ, Kontrolluesi ndërmori masa konkrete dhe të menjëhershme për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, duke vendosur *“Politikat e Privatësisë”* në faqen [www.autoritetidosjeve.gov.al/](http://www.autoritetidosjeve.gov.al/), të institucionit.

Gjithashtu, Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të Zyrës së Komisionerit, Rregulloren *“Për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në AIDSSH”*, si dhe ka *“Njoftuar”* Zyrën e Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

Sa më sipër, nga verifikimi i *“Njoftimit”* të kontrolluesit, mbi përpunimin e të dhënave personale, është konstatuar se është i nevojshëm përditësimi i tij, sa i përket rubrikave: 1.1 *“Të dhënat e subjektit kontrollues”*; 1.2 *“Personi i kontaktit”*; 6 *“Qëllimi i përpunimit”* dhe 10.1 *“Masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale”* të Formularit të Njoftimit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 29, 30, 31 dhe pika 1, e nenit 32, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi *“Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”*, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e *“Njoftimit”* pranë Zyrës

së Komisionerit, në lidhje me "të dhënat e subjektit kontrollues", "personin e kontaktit", "qëllimet e përpunimit" dhe "masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale".

2. Kontrolluesi "Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objektin e kontrollit të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
3. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 27.02.2019.

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

